



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRËSA**  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

**RREGULLORE NR. 01/2024**  
**PËR PROCEDURAT E PARASHTRIMIT DHE VENDOSJES SË ANKESAVE**

## **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa,**

Në mbështetje të nenit 115, paragrafi 1, nenit 117, paragrafi 1 dhe nenit 127 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më datën 05 korrik 2024.

Miraton:

### **RREGULLORE PËR PROCEDURAT E PARASHTRIMIT DHE VENDOSJES SË ANKESAVE**

#### **KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

##### **Neni 1 Qëllimi**

1. Me këtë rregullore përcaktohet procedura e parashtrimit të ankesave të personave të autorizuar, shqyrtimi dhe vendosja e tyre në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, siç përcaktohet me legjislacionin në fuqi.

2. Me këtë rregullore gjithashtu përcaktohet forma dhe përmbajtja e ankesave, mënyra e ruajtjes dhe arkivimi i tyre, afatet, identifikimi dhe vërtetimi i parregullsisë të pretenduara, kategorizimi i gjobave dhe shqiptimi i tyre, njoftimi i palëve dhe publikut, si dhe rregullat e vendimmartjes.

##### **Neni 2 Fushëveprimi**

Kjo rregullore zbatohet nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, personat e përfshirë në procedurë, subjektet politike, kandidatët dhe të gjithë personat e tjerë të drejtat e të cilëve supozohet se janë shkelur lidhur me procesin zgjedhor.

##### **Neni 3 Përkufizimet**

1. Për qëllim të kësaj Rregullore, shprehjet e përdorura në vijim, kanë kuptim të njëjtë sikurse në Ligjin Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe dispozitat tjera ligjore në fuqi:

1.1. **PZAP**- Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa;

- 1.2. **Ankesë** - mjet i rregullt juridik i parashtruar nga personi që ka interes ligjor, të drejtat e të cilit supozohet se janë shkelur gjatë procesit zgjedhor;
- 1.3. **Afat** - koha brenda të cilit duhet të kryhet apo mund të kryhet veprimi procedural i caktuar;
- 1.4. **KQZ** - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve;
- 1.5. **ZYRA** - Zyra për Regjistrim, Certifikim dhe Kontroll Financiar të Subjekteve Politike;
- 1.6. **QNR** - Qendra e Numërimit dhe e Rezultateve;
- 1.7. **QKN** - Qendra Komunale e Numërimit;
- 1.8. **KKZ** - Komisioni Komunal i Zgjedhjeve;
- 1.9. **K VV** - Këshilli i Vendvotimit;
- 1.10. **KGJK**- Këshilli Gjyqësor i Kosovës;
- 1.11. **QV**- Qendra e Votimit, vendi ku gjenden një ose më tepër vendvotime;
- 1.12. **VV**- Vendvotimi, hapësira në objektin ku kryhet votimi;
- 1.13. **OJQ** - Organizata Jo Qeveritare;
- 1.14. **FRS** - Formulari i rezultateve të subjekteve;
- 1.15. **FRSKK**- Formulari i rezultateve të subjekteve për kuvendin komunal
- 1.16. **FRK**- Formulari i rezultatit të kandidatëve;
- 1.17. **FRKK**- Formulari i rezultatit të kandidatëve për kryetar
- 1.18. **FRD** - Formulari i rezultatit të Dengut;
- 1.19. **Hetimi** - identifikimi dhe vërtetimi i parregullsive të pretenduara;
- 1.20. **LV** - Lista e Votuesve;
- 1.21. **LVK** - Lista e Votuesve me Kusht;
- 1.22. **SMA** - Sistemi për Menaxhimin e Ankesave;
- 1.23. **VPNV** - Votimi i Personave me Nevoja të Veçanta;

1.24. **Votues Jashtë Kosovës** -Votues jashtë Kosove me të drejtë vote;

1.25. **Vëzhgues të akredituar** - Përfaqësuesi i një subjekti të certifikuar politik, organizatë joqeveritare, qeveritare, organizatë ndërkombëtare;

1.26. **Subjekt politik** - Parti politike, koalicion, nismë qytetare ose kandidatë i pavarur;

1.27. **KPM** – Komisioni i Pavarur për Media.

## **KAPITULLI II**

### **SUBJEKTET ANKUESE DHE MENYRA E PARAQITJES SE ANKESAVE**

#### **Neni 4**

##### **E drejta për parashtrim të ankesës**

1. Ankesë në PZAP, mund të parashtroj personi që ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-it, të drejtat e të cilit janë shkelur gjatë procesit zgjedhor:

1.1. qytetarët me të drejtë vote nëse u është cenuar e drejta personale e votës gjatë procesit të votimit brenda dhe jashtë Kosovës;

1.2. përfaqësuesit e subjekteve politike;

1.3. kandidati për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës;

1.4. kandidati për anëtar të Kuvendit Komunal;

1.5. kandidati i pavarur;

1.6. kandidati për Kryetar të Komunës;

1.7. anëtarët e Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve (KKZ), dhe anëtarët e Këshillave të Vendvotimeve;

1.8. përfaqësuesi i autorizuar i personit juridik;

1.9. përfaqësuesit e OJQ-ve dhe vëzhguesit e akredituar nga KQZ;

1.10. zyra në pajtim me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës mund të parashtrojë ankesë në PZAP, si dhe;

1.11. të gjithë personat që kanë interes ligjorë të drejtat e të cilëve u janë shkelur ashtu siç përcaktohet me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Ligjin për Zgjedhjet Lokale dhe rregullat zgjedhore.

#### **Neni 5**



## **Përmbajtja e ankesave**

1. Ankesa që dorëzohet në PZAP për shqyrtim duhet të përmbajnë këto të dhëna:

- 1.1. emrin, mbiemrin, adresën e personit fizik apo juridik (adresa elektronike apo eventualisht numri kontaktues) i cili është ankuar;
- 1.2. vendin (Komuna, vendbanimi, Qendra e Votimit, Vendvotimi ku konsiderohet se ka ndodhur shkelja e supozuar);
- 1.3. kohën (data dhe ora) kur ka ndodhur shkelja;
- 1.4. përshkrimin e shkeljes së supozuar;
- 1.5. të dhënat lidhur me kryesin e supozuar si në pikën 1.1 të këtij neni;
- 1.6. provat shkresore me të cilat do të mbështeten pretendimet ankimore;
- 1.7. nënshkrimin e personit ankues.

### **Neni 6**

#### **Forma dhe mënyra e dorëzimit të ankesave**

1. Dorëzimi i ankesës në PZAP, bëhet nga personi që ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-it personalisht ose përmes përfaqësuesit të autorizuar.
2. Ankesa nga personi me interes ligjor parashtrohet me shkrim dhe dorëzohet drejtpërdrejtë në PZAP, ose përmes postës e cila duhet të ketë vulën dhe pullën postare të postës së origjinës prej cilit vend është dërguar ankesa.
3. Përrjashtimisht nga paragrafi 2 i këtij neni, personat (votuesit potencial) që jetojnë jashtë Kosovës, ankesën mund ta dorëzojnë në PZAP, përmes postës elektronike: [Info@pzap-ks.org](mailto:Info@pzap-ks.org). Ankesa dërgohet vetëm nga email-i personal i ankuesit, e cila duhet të jetë e nënshkruar nga personi ankues, të jetë e skanuar, dhe duhet t'i ketë të bashkangjitura dokumentet valide të lëshuara nga organet e Republikës së Kosovës të cilat e identifikojnë ankuesin.
4. Personi që ka interes ligjor mund të parashtron ankesë sipas paragrafit 2 ose 3 të këtij neni i cili duhet të plotësoj formularin e PZAP-it, (formulari numër 1 që është pjesë e kësaj rregullore). Formulari mund të merret në Sekretariatën e PZAP-së, në ueb-faqen [www.pzap-ks.org](http://www.pzap-ks.org), si dhe në të gjitha qendrat e votimit në ditën e zgjedhjeve.
5. Përrjashtimisht paragrafit 4 të këtij neni, pala në pamundësi të përdorimit të Formularit standard të hartuar nga PZAP-i, mund të parashtroj ankesë në PZAP duke përdorur letër të zakonshme, por që duhet të përmbajë të dhënat e ankesës si në nenin 5 paragrafi 1. të kësaj rregullore.
6. Ankesat e parashtruara nga grup ankuesish pranohen në PZAP në pajtim me dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

7. Ankesat duhet të parashtrohen me shkrim në njërën nga gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me ligjin për gjuhët.

8. Ankesa konsiderohet se është parashtruar në ditën e dorëzimit në PZAP, ose ditën kur është dorëzuar në postë.

## **Neni 7**

### **Pranimi dhe Regjistrimi i ankesave**

1. Procedura dhe rrjedha e afateve fillon me dorëzimin e ankesës në PZAP. PZAP-i krijon dhe mbanë një regjistër të posaçëm për ankesat i cili administrohet në formën fizike dhe elektronike. Pranimi i ankesave, bëhet nga zyrtari i pranimit i cili bënë edhe regjistrimin e tyre.

2. Regjistri i ankesave përmban:

2.1. numrin rendor të ankesës;

2.2. datën dhe orën e pranimit;

2.3. subjektin ankimues;

2.4. objektin e ankesës;

2.5. numrin dhe llojin e dokumenteve që i bashkëngjiten ankesës;

2.6. ankesa vuloset me vulën pranuese të PZAP-it.

3. Pas regjistrimit të ankesës personit ankues i dorëzohet nga PZAP një vërtetim me të cilin dëshmohet dorëzimi i ankesës.

4. PZAP-i, nuk mund të refuzojë për asnjë shkak mos pranimin dhe regjistrimin e ankesave.

5. Pas regjistrimit të ankesës, zyrtari i pranimit e përcjell ankesën në Departamentin Ligjor, për tu proceduar më tutje në panel.

6. Pas procedurave të regjistrimit, lënda skanohet dhe ruhet në mënyrë fizike dhe elektronike, në Sistemin për Menaxhimin e Ankesave (SMA) si dhe krijohet dosja e veçantë për secilin rast me përmbledhjen e të gjitha shkresave.

7. Për ankesat e dorëzuara në PZAP, personat ankues dhe personat e interesuar, mund të informohen në çdo kohë në lidhje me ecurinë e procesit të tyre përmes Sistemit të Menaxhimit të Ankesave/SMA.

## **KAPITULLI III FAZAT DHE AFATET PËR PARASHTRIMIN E ANKESAVE**

### **Neni 8 Fazat e paraqitjes se ankesave**

1. Personi sipas nenit 4 të kësaj rregullore, ka të drejtë ankesë në të gjitha fazat e procesit zgjedhor me pretendimin se i janë shkelur të drejtat e tij zgjedhore të përcaktuara më LZP-së, si në vijim:

1.1. nga data e shpalljes së ditës së zgjedhjeve, përfshi fushatën zgjedhore deri në hapjen e Qendrave të Votimit për votim,

1.2. nga hapja e Qendrave të Votimit për votim, e deri në mbylljen e tyre, përfshi thyerjen e heshtjes zgjedhore në ditën e votimit si dhe për parregullsitë që ndërliken me procesin e votimit;

1.3. pas ditës së votimit deri në shpalljen e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve;

2. Personi, gjithashtu mund të parashtroj ankesë në PZAP, edhe jashtë fazave të parapara në paragrafin 1 të këtij neni, nëse supozohet se të drejtat e tij janë shkelur me vendim të KQZ-së.

### **Neni 9 Afati për parashtrimin e ankesës**

1. Personi fizik ose juridik i cili ka interes ligjor mund të parashtrojë ankesë në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-it, të drejtat e të cilit janë shkelur sipas dispozitave të LZP-së ose rregullave zgjedhore.

2. Personi mund të parashtrojë ankesë ndaj vendimit të KQZ-së, nga momenti i pranimit të vendimit, apo kur i njëjti është shpallur publikisht në ueb faqen e KQZ-së.

3. Afati i parashtrimit të ankesës llogaritet në orë.

4. Personi mund të paraqes ankesë në PZAP brenda njëzet e katër (24) orëve kundër vendimit të KQZ-së, lidhur me:

4.1. refuzimin për certifikimin e listës së kandidatëve.



5. Personi mund të paraqes ankesë në PZAP, brenda dyzet e tetë (48) orëve për shkeljet e pretenduara:

5.1. personi që dëshiron të kundërshtojë një emër që mendon se nuk duhet të jetë në listën e votuesve;

5.2. personi që edhe pas rishikimit nga KQZ-ja, nuk është përfshirë në listën e votuesve;

5.3. aplikuesit jashtë Kosovës të cilit i është refuzuar kërkesa për tu regjistruar dhe përfshirë në listën e votueseve jashtë Kosovës;

5.4. refuzimin për certifikim të subjekt politik;

5.5. për shkeljet e pretenduara të Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët;

5.6. zyra ndaj subjektit politik për mos dorëzimin ose të dorëzimit jo të plotë ose të pasakt të Raportit të Publikimit Financiar të Fushatës;

5.7. ndaj shkeljeve në fushatën zgjedhore dhe njoftimit për ngjarjet politike;

5.8. për shkeljet e subjekteve politike në lidhje me mediat gjatë fushatës zgjedhore;

5.9. refuzimin e subjektit politik, organizatës, medium apo individ që ka aplikuar për akreditim për vëzhgues të procesit zgjedhor;

5.10. refuzimin për mosemërimin e anëtarit të KKZ-ve;

5.11. refuzimin për mosemërimin e kryesuesit dhe anëtarëve të këshillave të vendvotimit, KVV-ve;

5.12. ndaj subjektit politik i cili ka postuar material të fushatës zgjedhore pas afatit kohor të përcaktuar për publikim/vendosje, ose nuk janë larguar materialet e fushatave të tyre zgjedhore të vendosura brenda dhe rreth cilitdo VV ose QV në objektin e shkollës/qendrës dhe oborrin e saj;

5.13. votuesi në lidhje me ndonjë aktivitet brenda VV-së;

5.14. mos përfshijë ose përjashtimi i votuesit me të drejtë vote nga lista e votuesve e VPNV-së;

5.15. anëtar i komisionit të vendvotimit që ka vërejtje në rezultatet e shënuara në një vendvotim;

5.16. për shkeljet e pretenduara gjatë procesit të administrimit dhe numërimit në QNR dhe QKN;



5.17. lidhur me shpalljen e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve nga KQZ-ja;

5.18. për shkeljet e pretenduara në ditën e votimit, nga momenti i mbylljes së Qendrës së Votimit.

### **Neni 10**

#### **Afati për vendimmarrje në ankesë**

1. PZAP-ja për të gjitha ankesat që mund të parashtrohen si në nenin 9 të kësaj Rregulloreje, vendos brenda këtyre afateve:

1.1. për ankesat që parashtrohen sipas nenit 9, paragraf 4, nën paragrafit 4.1, dhe paragrafit 5, nën paragrafit 5.4 të kësaj rregulloreje, PZAP-i vendos brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i pranimit të tyre.

1.2. për ankesat që parashtrohen sipas nenit 9, paragraf 5, nën paragrafit 5.1, 5.2, 5.5, 5.7, 5.8, 5.9, 5.10, 5.11, 5.12 dhe 5.16 të kësaj rregullore, PZAP-i vendos brenda shtatëdhjetë (72) orëve nga momenti i pranimit të tyre.

1.3. ndërsa për ankesat që parashtrohen sipas nenin 9, paragrafit 5 nën paragrafit 5.3, 5.13, 5.15, 5.17, dhe 5.18 të kësaj rregullore, PZAP-i vendos brenda nëntëdhjetë e gjashtë (96) orëve nga momenti i pranimit të tyre.

2. Në rastin kur me ligj lejohet ankesa dhe shqyrtimi i tyre është brenda juridiksionit të PZAP-it, por që shprehimisht nuk është përcaktuar afati për parashtrimin e ankesës dhe vendosjes, vepohet si vijon:

2.1. Për rastet që nuk është paraparë afati i parashtrimit të ankesës, e janë potencuar në nenin 9, paragraf 5, nën paragrafi 5.6, 5.14, të kësaj rregullore, parashtrimi tyre bëhet brenda afatit prej dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i pranimit të vendimet, ndërsa vendimmarrja nga PZAP-i, bëhet brenda nëntëdhjetë e gjashtë (96) orëve nga momenti i pranimit të tyre.

## **KAPITULLI IV**

### **PROCEDURA PERGADITORE E SHQYRTIMIT TË ANKESAVE DHE VENDIMARRJA**

#### **Neni 11**

##### **Veprimet përgatitore për ankesat e pranuar**

1. Shqyrtimi i ankesës fillon menjëherë pas pranimit dhe regjistrimit në mënyrën fizike dhe elektronike, e cila menjëherë përcillet nga zyra e arkivit në Departamentin Ligjor për trajtim të mëtejshëm.

2. Administrimi i procesit të ankesës në fazën paraprake kryhet nga Departamenti Ligjor, i cili ofron edhe mbështetjen profesionale Panelit për shqyrtimin e ankesave. Përmes zyrtarit përgjegjës përcillen shkresat e lëndës të kompletuara tek Paneli për trajtim të mëtejshëm.
3. Dërgimi i ankesës për përgjigje tek palët, përgatitja e draft vendimeve, si dhe ndërmarrja e veprimeve që kërkohet të kryhen në kuadër të Departamentit Ligjor, bëhet sipas konstatimeve të Panelit.
4. Brenda Departamentit Ligjor bëhet shpërndarja e ankesave sipas numrit rendor, ku për secilën ankesë caktohet zyrtari përgjegjës, i cili njëkohësisht është këshilltar ligjor i Panelit dhe pjesë e njërit nga panelet e gjyqtarëve të cilëve u ndahet lënda në kompetencë.
5. Departamenti Ligjor, konstaton se ankesa varësisht nga mënyra e parashtrimit të saj është pranuar në datën dhe orën e dorëzimit në zyrën e PZAP-it, me dëshminë e vulës, pullës postare të origjinës prej nga është dërguar ankesa, si dhe dëshmisë së dërguar nga emali i personit jashtë Kosovës.
6. Në rast se personi ankues jashtë Kosovës, nuk ka dërguar ankesën nga emali i tij personal, PZAP-i e njofton personin menjëherë se nuk e shqyrton ankesën që dorëzohet nga adresa elektronike apo emali i personave tjerë, edhe nëse ata janë anëtarë të të njëjtës familje.
7. Në rastin e pranimit të ankesës kur personi nuk figuron në listën votueseve, Departamenti Ligjor e njofton KQZ-në, dhe çdo palë tjetër ndaj së cilës është parashtruar ankesa. Palëve u jepet mundësia për t'u përgjigjur, duke kërkuar se çdo përgjigje në ankesë duhet të pranohet brenda dy (2) ditëve të punës prej njoftimit nga PZAP-i që ankesa është pranuar.
8. Personi ose përfaqësuesi ligjor para marrjes së vendimit nga Paneli lidhur me ankesën e parashtruar, mund të paraqet kërkesë për tërheqjen e saj.
9. Ankesa që nuk i plotëson kriteret sipas nenit 5 të kësaj rregullore i kthehet personit ankues në plotësim dhe përmirësim në afat të caktuar nga Paneli deri në njëzet e katër (24) orë. Ankesa do të konsiderohet e tërhequr nëse nuk i kthehet përgjigje PZAP-it, në afatin e dhënë, e në qoftë se kthehet e pa plotësuar do të hedhet poshtë.
10. Zyrtari përgjegjës për rastin ankimor, i dërgon palëve të përfshira në ankesë njoftimin për përgjigje së bashku me kopjen e saj. Afati për përgjigje nuk mund të jetë më i gjatë se njëzet e katër (24) orë. Në rast se palët nuk përgjigjen në ankesë brenda afatit të caktuar, PZAP-i, pa të njëjtën do të procedojë çështjen.
11. PZAP-i para shqiptimit të gjobës mund të kërkoj nga pala ndaj së cilës është paraqitur ankesa se e njëjta mund të ndërmarr masa përmirësuese brenda afatit të përcaktuar nga PZAP. Urdhri për përmirësim të shkeljes, ka për qëllim që palës ti ofrohet mundësi në eliminimin ose zvogëlimin e shkeljes, para se PZAP-i të nxjerr vendim.
12. Përgjigja me shkrim që ofrohet si në paragrafin 10 dhe 11 të këtij neni, duhet të jetë e nënshkruar nga personi ose përfaqësuesi i autorizuar, dhe duhet të përmbajë informatat vijuese:

12.1. emrin, adresën dhe informatat për kontaktim të personit ndaj së cilës është parashtruar ankesa;



12.2. mbrojtjen kundër shkeljes së pretenduar me ankesë, dhe pretendimet mbrojtëse kundrejt shkeljes së supozuar, nuk përbëjnë shkelje të re;

12.3. argumentimin nga personi ndaj së cilës është parashtruar ankesa

12.4. hollësitë rreth çfarëdo dëshmie dhe kopjet e cilit do dokumentacion relevante,

12.5. emrin, adresën dhe informacionet për kontaktim të cilit do dëshmitar; dhe

12.6. çdo informacion tjetër të rëndësishëm.

13. Në rastin kur PZAP-i, i ofron mundësin personit për përmirësimin e shkeljes së bërë, përpos të dhënave të kërkuara në paragrafin 11 të këtij neni, personi duhet të sjell dëshmitë lidhur me ndër marrjen e masës përmirësuese për evitimin e shkeljes së pretenduar në ankesë

## **Neni 12**

### **Përbërja e paneleve dhe procesi i shqyrtimit të ankesave**

1. Para çdo procesi zgjedhor, Kryesuesi i PZAP-it me vendim cakton përbërjen e paneleve nga radha e anëtarëve të PZAP-it, i cili nuk mund të jetë me më pak se tre (3) anëtarë. Nga mesi i tre anëtarëve njëri prej tyre zgjidhet për kryesues të Panelit.

2. Kryesuesi i PZAP-it, ndan lëndën në panelin shqyrtues sipas numrit rendor të pranimin dhe regjistrimit të lëndës në arkivin e PZAP-it. Zyrtari përgjegjës nga Departamenti Ligjor kujdeset për administrimin e procesit deri në nxjerrjen dhe plotfuqishmërinë e vendimit.

3. PZAP-i, kur vlerëson te nevojshme mbanë seancë dëgjimore për qëllim të vendosjes lidhur me ankesën.

4. PZAP-i, mban seanca dëgjimore të obligueshme me palët, në rastet kur ankesa në PZAP është parashtruar nga subjekti politik dhe çështja kontestuese lidhet me certifikimin apo rezultatin zgjedhor të subjektit politik ose kandidatit për kryetar komune.

## **Neni 13**

### **Vendimmarrja e PZAP-it**

1. PZAP-i, vendos për të gjitha ankesat ndaj vendimeve të KQZ-së, të përcaktuara shprehimisht me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme.

2. PZAP-i, aprovon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat në mungesë të provave.

3. PZAP-i, e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk përmbush kërkesat e LZP-së dhe kësaj rregullore për shqyrtim:

3.1. ankesa nuk është parashtruar nga personi me të drejt ankese;

3.2. nuk i përmban të gjitha element që duhet të ketë një ankesë;

3.3. nuk është dorëzuar në afatit e paraparë ligjor;

3.4 nuk përmban të gjitha elementet e formularit standarde ose në letër të zakonshme nuk i ka përfshi të gjitha elementet e tij, si dhe nuk ju ka përmbajit mënyrës së dorëzimit të ankesës.

4. PZAP-i nuk do të veproj ndaj ankesave të cilat nuk i plotësojnë kushtet e përcaktuara në rregullat e procedurës. PZAP-i mund në përgjithësi të refuzoj një ankesë apo grup ankesash nëse ato nuk paraqesin raste *prima facie* ose ku ankesa apo grupi i ankesave është dukshëm i pabazë.

5. Në rastin kur pala ankuese paraqet kërkesë për tërheqje të ankesës, PZAP-i lidhur me këtë merr vendim pa u lëshuar në shqyrtim.

6. Paneli para se të vendos lidhur me ankesën mund të kryej hetim nëse e konsideron të nevojshme dhe të arsyeshme.

7. Në rastin e caktimit të sanksioneve apo të gjobave, Paneli siguron që sanksioni të jetë në proporcion me shkeljen e bërë, dhe mund të vendosë një gjobë ndaj një subjekti politik, në vlerë deri në pesëdhjetëmijë (50,000 €) Euro;

8. PZAP-i mundë të urdhëroj një subjekt politik ose një organizatë vëzhguese të ndërmarrë masa përmirësuese.

9. Paneli me vendimin e tij mund të urdhëron KQZ-në, që të rishqyrtojë vendimin e vet dhe të marrë masa përmirësuese, apo që Paneli të ndryshon vendimin e KQZ-së dhe të vendos vet për çështjen e objektit lëndor.

10. Në rast se PZAP-i, konstaton se ka ndodhur shkelje e LZP-së dhe rregullave zgjedhore të KQZ-së, para certifikimit të rezultateve zgjedhore është në kompetencë të PZAP-it, që në raste të jashtëzakonshme:

10.1. të urdhëroj KQZ-në, që të rinumëroj fletëvotimet në një vendvotim apo qendër votimi;

10.2. të anuloj rezultatet në një vendvotim apo qendër të votimit;

10.3. të urdhëroj KQZ-në, ti përsëris votimin në një vendvotim apo qendër votimi, nëse konsideron që ka ndikim në rezultatet finale.

11. Në rast se ka ndodhur një shkelje e LZP-së ose e rregullave zgjedhore e cila e minon integritetin e zgjedhjeve, PZAP-i mund të:

11.1. largojë një kandidat nga lista e kandidatëve, kur të dëshmohet se kandidati ishte përgjegjës për këtë shkelje;



11.2. largojë një apo disa kandidatë nga lista e kandidatëve të një subjekti politik dhe të mos e lejoj subjektin politik t'i zëvendësojë kandidatët e larguar, nëse PZAP-ja përcakton se subjekti ishte përgjegjës për këtë shkelje;

11.3. decertifikojë një subjekt politik nga pjesëmarrja në zgjedhje; dhe

11.4. ndalojë një individ të marr pjesë në zgjedhjet e mbajtura nën autoritetin e KQZ-së, si kandidat apo edhe si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor, për një periudhë kohore që nuk i kalon gjashtë (6) vite.

#### **Neni 14**

#### **Përmbajtja, e drejta e korigjimit dhe marrja e formës së prerë e vendimeve**

1. Vendimet e PZAP-it, lidhur me ankesat përpilohen me shkrim dhe duhet të jenë në gjuhët zyrtare. Vendimi përgatitet në ekzemplare të mjaftueshëm, nënshkruhet dhe vuloset, në pajtim me Ligjin.

2. PZAP-i, mund të rishikoj dhe korigjoj cilindo nga vendimet e tij të marra. Rishikimi ose korigjimi i vendimit mund të bëhet ex officio ose me kërkesë të palës.

3. Vendimet e PZAP-it, janë të detyrueshme për tu zbatuar nga KQZ-ja përveç nëse Gjykata Supreme e Kosovës vendos ndryshe.

4. Vendimi i PZAP-it merr formë të prerë, nëse pala brenda dyzet e tetë (48) orëve, nga momenti i pranimit të vendimit nuk dorëzon ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës.

5. Dështimi për të paguar dënimin, apo për t'ju bindur një urdhërese të PZAP-it, brenda një periudhe kohore të saktësuar në vendimin e PZAP-it, është një shkelje tjetër e këtij ligji që mund të sanksionohet me dënim shtesë nga PZAP-i.

6. PZAP-i, përveç dënimeve me gjobë në rast se konstaton se ka ndodhur shkelje e dispozitave ligjore dhe rregullave zgjedhore, të cilat minojnë integritetin e zgjedhjeve, mund të shqiptojë dënime shtesë dhe sanksionime tjera, sipas nenit 120 paragrafi 2 të LZP-së.

### **KAPITULLI V**

### **PROCEDURA PËR ADMINISTRIMIN E HETIMEVE TË MATERIALIT ZGJEDHOR**

#### **Neni 15**

#### **Zhvillimi i Hetimeve të Materialit Zgjedhor**

1. Kur PZAP-i, pranon një ankesë që konsiderohet të jetë e rregullt dhe e lejuar, dhe kur një ankesë e tillë pretendohet se ka dyshime të bazuara, për parregullsi të përfshira në materialin zgjedhor PZAP-i, do të autorizoj një anëtar të Panelit, si hetues kryesor dhe zyrtarë tjerë të nevojshëm nga Sekretariati i PZAP-it, të ngarkuar në çështjen konkrete që ti zhvillojnë/kryejnë hetimet.

2. Ekipi hetues i autorizuar nga PZAP-i, është i obliguar që të formoj një dosje të lëndës duke detajuar të gjitha materialet zgjedhore të kopjuara dhe përgatit një raport hetues, duke siguruar një analizë të hollësishme të materialit zgjedhor dhe ja paraqet Panelit për shqyrtim në seancë.

3. Duke u bazuar në ankesat e paraqitura për shkeljet e supozuara në QNR, QKN, PZAP-i, mund t'i kryej këto hetime:

3.1. hetimi i kutisë së votimit;

3.2. hetimi i librit të votimit;

3.3. hetimi i listës përfundimtare të votuesve;

3.4. hetimin e listës së votuesve me kusht;

3.5. hetimi i formularit të rezultateve të subjekteve;

3.6. hetimi i formularit të rezultateve të subjekteve për kuvendin komunal;

3.7. hetimi i formularit të rezultatit të kandidatëve;

3.8. hetimi i formularit të rezultatit të kandidatëve për kryetar;

3.9. hetimi i fletëvotimeve të rregullta;

3.10. hetimi i fletëvotimeve të personave me nevoja të veçanta;

3.11. hetimi i zarfeve të fletëvotimeve të votuesve me kusht;

3.12. hetimi i fletëvotimeve të votuesve përmes postës.

4. PZAP-i, përmes kërkesës zyrtare në kopje fizike apo elektronike kërkon nga QNR, QKN, KQZ, që të sigurohet materiali zgjedhor, si në paragrafin 3 të këtij neni, si dhe të sigurojë hapësirat e nevojshme për ekipin hetues të autorizuar nga PZAP-i, për të kryer hetim të materialit zgjedhor për një vendvotim apo qendër të votimit.

### **Neni 16** **Hetimi në Kutinë e Votimit**

1. Në rastin e këtij hetimi fillimisht verifikohen numrat e shiritave mbyllës të kutive të votimit, pastaj bëhet krahasimi i numrave të shiritave të sigurisë, me të dhënat nga dokumentacionet përkatëse, verifikohen materialet tjera si FPR-ja, FRK-ja, LPV-ja, lista e votuesve me kusht, libri i votimit, dhe thasët e mbyllur të fletëvotimeve me kusht dhe atyre jashtë Kosovës.

2. Për vendvotimin e caktuar për hetim hapen thasët e mbyllur dhe bëhet verifikimi i zarfeve të fletëvotimeve me kusht ZFK, fletëvotimet e votimeve për personat me nevoja të veçanta VPNV-ve, dhe fletëvotimet nga votuesit jashtë Kosovës.

3. Kutitë e votimit të cilat janë vlerësuar nga zyrtarët e pranimit të QNR-së, si të parregullta dhe të cilat janë vendosur në pjesën e karantinës, mund ti nënshtrohen hetimit nga zyrtarët hetues të PZAP-it, si rezultat i ndonjë ankese.

4. Pas kryerjes së hetimeve nga Paneli, kutia e votimit mbyllet me shirita tjerë të sigurisë, ku numrat e shiritave regjistrohen në raportin e hetimit.

### **Neni 17** **Hetimi në Librin e Votimit**

1. Hetimi i librit të votimit ka të bëjë me mbarëvajtjen e procesit zgjedhor gjatë ditës së zgjedhjeve në një vendvotim të caktuar.

2. Përmes librit të votimit identifikohet identiteti dhe pjesëmarrja e anëtareve të KVV-ve dhe vëzhguesve të akredituar në një VV.

### **Neni 18** **Hetimi i Listës Përfundimtare të Votuesve dhe Lista e Votuesve me Kusht**

1. Hetimi listës përfundimtare të votuesve dhe lista e votuesve me kusht, bëhet:

1.1. duke krahasuar numrin e nënshkrimeve në listën përfundimtare të votuesve, me numrin e përgjithshëm të fletëvotimeve të rregullta të gjetura në kutinë e votimit;

1.2. hetimi i nënshkrimeve lidhur me vërtetësinë e nënshkrimeve;

1.3. hetohet numri i emrave në LVK, me numrin e zarfeve të gjetura në thesin e ZFK-ve.

### **Neni 19** **Hetimi i Formularit të Rezultateve të Subjekteve Politike dhe Subjekteve për Kuvendin Komunal**

1. Këto të dhëna verifikohet duke i krahasuar fletëvotimet në atë vendvotim me të dhënat ekzistuese në FRS dhe FRSKK ose në LPV.

2. Fletëvotime të paplotësuara konsiderohen fletëvotimet e zbrazëta të vendosura në kutinë e votimit.

3. Bëhet kontrollimi dhe krahasimi i fletëvotimeve të vlefshme, të papërdorura, të prishura, të paplotësuara dhe të pavlefshme me numrin e përgjithshëm të fletëvotimeve në atë vendvotim.



4. Bëhet krahasimi i votave në formular, të fituara nga secili subjekt politik dhe kandidatë të pavarur, duke i krahasuar me fletëvotimet e vlefshme të cilat gjenden në kuti të votimit.
5. Evidentohet numri i shiritave që përdoren për mbylljen e kapakut të kutisë së votimit për çdo vendvotim, dhe numri i shiritit që përdoret për mbylljen e vrimës së kutisë së votimit.
6. Identifikohet vërtetësia dhe pjesëmarrja e anëtareve të KVV-së, në atë vendvotim.
7. Bëhet krahasimi dhe vërtetimi i të dhënave tjera të cilat janë të evidentuara në formularë.

#### **Neni 20**

##### **Hetimi i Formularit të Rezultateve të Kandidatëve dhe për Kryetar Komune**

1. Përmes këtij hetimi bëhet krahasimi i votave të fituara të vlefshme të cilat gjenden në kutinë e votimit, me votat e kandidatëve brenda subjekteve të ndryshme politike si dhe të vetë subjektit politik, me votat e evidentuara dhe të shënuara në formularë.
2. Identifikohet vërtetësia dhe pjesëmarrja e anëtareve të KVV-së, në atë vendvotim.
3. Krahasimi bëhet duke u bazuar me të dhënat ekzistuese në formularë dhe kuti të votimit.

#### **Neni 21**

##### **Hetimi i Fletëvotimeve**

1. Varësisht nga pretendimet ankimore, bëhet hetimi i fletëvotimeve të përgjithshme duke i klasifikuar fletëvotimet si në vijim: fletëvotime të paplotësuara, të pavlefshme, fletëvotime të vlefshme, fletëvotime të pa përdorura (të mbetura).
2. Fletëvotimet e pavlefshme konsiderohen fletëvotimet, nëse:
  - 2.1. në fletëvotim është shënuar me shumë se një subjekt politik;
  - 2.2. mënyra se si është shënuar, e bën qëllimin e votuesit të paqartë;
  - 2.3 fletëvotimet nuk janë vulosur me vulë zyrtare, në përjashtim të fletëvotimeve për votim përmes postës, ku nuk kërkohen të vulosen.
3. Fletëvotim i vlefshëm konsiderohet ai i cili i plotëson kriteret e parapara me ligj dhe rregulla zgjedhore.
4. Fletëvotime të pa përdorura (të mbetura) konsiderohen të gjitha fletëvotimet të mbetura nga numri i fletëvotimeve të cilat kanë qenë të parapara për votim.

#### **Neni 22**



## **Hetimi i Formularëve të Rezultateve të Dengut (FRD)**

1. Në këtë rast bëhet hetimi i Zarfeve të Fletëvotimeve me Kusht, Zarfeve të Fletëvotimeve të votimit të personave me nevoja të veçanta, dhe Zarfeve të Fletëvotimeve të votimit përmes postës, të cilat janë të parapara nga KQZ-ja.
2. Në rast të paraqitjes së ndonjë parregullsie të gjatë numërimit të fletëvotimeve të votimit përmes postes, PZAP-i, bën hetimin e këtyre rasteve.

### **Neni 23**

#### **Përgatitja e Raportit të Hetimit**

1. Pas secilit hetim të materialit zgjedhor, kryesuesi i ekipit hetimor përpilon procesverbalin dhe përgatit raportin hetues për të dhënë sqarime më të hollësishme rreth të gjeturave të materialit zgjedhor.
2. Procesverbali dhe raporti hetues, së bashku me materialin zgjedhor të kopjuar, i paraqitet Panelit të PZAP-it, për shqyrtim të mëtutjeshëm.

## **KAPITULLI VI**

### **GJOBAT DHE SANKSIONET**

#### **Neni 24**

#### **Kategorizimi i gjobave dhe shqiptimi i tyre**

1. PZAP-i, ka autoritet ligjor të marrë vendim dhe të shqiptojë sanksione për kompensim dhe përmirësim të shkeljes së dispozitave ligjore të LZP-së.
2. Të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre, detyrohen të zbatojnë dispozitat e LZP-së, Rregullat Zgjedhore dhe Kodin e Mirësjelljes për Subjektet Politike Mbështetësit e tyre dhe Kandidatet.
3. Në rast se PZAP-i, konstaton se ka ndodhur shkelje e dispozitave ligjore të LZP-së ose të rregullave zgjedhore të KQZ- së, mund të shqiptojë gjobë ndaj subjektit politik sipas LZP-së. Megjithatë PZAP përveçse se mund të shqiptoj gjobën në lartësinë maksimale sipas dispozitave të LZP-së, kur konstaton shkelje duhet të marrë për bazë kriteret për matjen e lartësisë së gjobës që parashihen në nenin 24 paragrafi 5 të kësaj rregullore dhe të vlerësoj ato rrethana që gjoba të shqiptohet sipas kategorive të mëposhtme, e posaçërisht vlerëson nëse shkelja është përsëritur.
4. Çdo vendosje e një gjobe ose sanksioni tjetër nga PZAP-i, është pa paragjykim ndaj ndonjë sanksioni penal që mund të pasojë në të ardhmen.

5. Gjatë shqiptimit të një gjobe ndaj një subjekti politik, për ndonjë shkelje të legjislacionit zgjedhor në Republikën e Kosovës, PZAP-i, merr parasysh kriteret në vijim që ndikojnë në lartësinë e gjobës, respektivisht rrethanat rënduese dhe lehtësuese, ndaj:

5.1. natyrës së shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;

5.2. shkallës dhe peshës së shkeljes;

5.3. nëse veprimi përbën përsëritje të shkeljes që për nga natyra është e njëjtë apo e ngjashëm

5.4. subjektit politik që ka bërë shkelje të legjislacionit zgjedhor, apo ka bërë shkelje të legjislacionit edhe në proceset e mëparshme zgjedhore;

5.5. subjektit politik që është përfitues i fondit për financimin e subjekteve politike;

5.6. shumën e fondeve për mbështetjen e subjekteve politike fondi për financimin e subjekteve politike përmes Buxhetit të Republikës së Kosovës i cili funksionon në kuadër të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

6. Për shkeljet, sipas paragrafit 1, nën paragrafit 1.1 dhe 1.2 të nenit 34 të LZP-së, PZAP-i, shqipton sanksione me gjobë ndaj subjektit politik:

6.1. Subjekti politik që është përfitues i fondit për financimin e subjekteve politike përmes Buxhetit të Republikës së Kosovës, dënohet me gjobë deri në njëzetmijë (20,000.00) euro;

6.2. Subjekti politik që nuk është përfitues i fondit për financimin e subjekteve politike përmes Buxhetit të Republikës së Kosovës, dënohet me gjobë deri në dhjetëmijë (10,000.00) euro;

7. Për shkeljet, sipas paragrafit 1, nën paragrafit 1.3 dhe 1.4 të nenit 34 të LZP-së, PZAP-i, shqipton sanksione me gjobë ndaj subjektit politik:

7.1. Subjekti politik që është përfitues i fondit për financimin e subjekteve politike përmes Buxhetit të Republikës së Kosovës, dënohet me gjobë deri në tridhjetëmijë (30,000.00) euro;

7.2. Subjekti politik që nuk është përfitues i fondit për financimin e subjekteve politike përmes Buxhetit të Republikës së Kosovës, dënohet me gjobë deri në njëzetmijë (20,000.00) euro;

8. Për shkeljet, sipas paragrafit 1, nën paragrafit 1.5, 1.6 të nenit 34 të LZP-së, PZAP-i, shqipton sanksione me gjobë ndaj subjektit politik:

8.1. Subjekti politik që është përfitues i fondit për financimin e subjekteve politike përmes Buxhetit të Republikës së Kosovës dënohet me gjobë deri në njëzet e pesë mijë (25,000.00) euro;

8.2. Subjekti politik që nuk është përfitues i fondit për financimin e subjekteve politike përmes Buxhetit të Republikës së Kosovës dënohet me gjobë deri në pesëmbëdhjetëmijë (15,000.00) euro.

9. Për shkeljet, sipas paragrafit 1, nën paragrafit 1.7, 1.8, 1.9, 1.10 dhe 1.11 të nenit 34 të LZP-së, PZAP-i, shqipton sanksione me gjobë ndaj subjektit politik:

9.1. Subjekti politik që është përfitues i fondit për financimin e subjekteve politike përmes Buxhetit të Republikës së Kosovës dënohet me gjobë deri në pesë dhjetëmijë (50,000.00) euro;

9.2. Subjekti politik që nuk është përfitues i fondit për financimin e subjekteve politike përmes Buxhetit të Republikës së Kosovës, dënohet me gjobë deri në pesë dyzetmijë (40,000.00) euro.

10. Për shkeljet, sipas nenit 35, paragrafi 1, 2 dhe 3 të LZP-së, PZAP-i, shqipton sanksione me gjobë ndaj subjektit politik:

10.1. Subjekti politik që është përfitues i fondit për financimin e subjekteve politike përmes Buxhetit të Republikës së Kosovës dënohet me gjobë deri në pesëdhjetëmijë (50,000.00) euro, ndërsa;

10.2. Subjekti politik që nuk është përfitues i fondit për financimin e subjekteve politike përmes Buxhetit të Republikës së Kosovës, dënohet me gjobë deri në dyzetmijë (40,000.00) euro.

11. Për shkeljet, sipas nenit 36, paragrafi 1, 2 dhe 3 të LZP-së, PZAP-i, shqipton sanksione me gjobë ndaj subjektit politik:

11.1. Subjekti politik që është përfitues i fondit për financimin e subjekteve politike përmes Buxhetit të Republikës së Kosovës dënohet me gjobë deri në pesëdhjetëmijë (50,000.00) euro, ndërsa;

11.2. Subjekti politik që nuk është përfitues i fondit për financimin e subjekteve politike përmes Buxhetit të Republikës së Kosovës, dënohet me gjobë deri në dyzetmijë (40,000.00) euro.

12. Për shkeljet, sipas nenit 37, paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe 1.2 të LZP-së, PZAP-i, shqipton sanksione me gjobë ndaj subjektit politik:

12.1. Subjekti politik që është përfitues i fondit për financimin e subjekteve politike përmes



Buxhetit të Republikës së Kosovës, dënohet me gjobë deri në njëzetepesëmijë (25,000.00) euro;

12.2. Subjekti politik që nuk është përfitues i fondit për financimin e subjekteve politike përmes Buxhetit të Republikës së Kosovës, dënohet me gjobë deri në njëzetmijë (20,000.00) euro.

13. Për shkeljet, sipas nenit 41, paragrafi 1 dhe 5 të LZP-së, PZAP-i, shqipton sanksione me gjobë ndaj subjektit politik:

13.1. Subjekti politik që është përfitues i fondit për financimin e subjekteve politike përmes Buxhetit të Republikës së Kosovës, dënohet me gjobë deri në njëzetmijë (20,000.00) euro;

13.2. Subjekti politik që nuk është përfitues i fondit për financimin e subjekteve politike përmes Buxhetit të Republikës së Kosovës, dënohet me gjobë deri në pesëmbëdhjetëmijë (15,000.00) euro.

14. Për shkeljet, sipas nenin 44 të LZP-së, PZAP-i, shqipton sanksione me gjobë ndaj subjektit politik:

14.1. Subjekti politik që është përfitues i fondit për financimin e subjekteve politike përmes Buxhetit të Republikës së Kosovës dënohet me gjobë deri në tridhjetëmijë (30,000.00) euro;

14.2. Subjekti politik që nuk është përfitues i fondit për financimin e subjekteve politike përmes Buxhetit të Republikës së Kosovës, dënohet me gjobë deri në njëzetepesëmijë (25,000.00) euro.

15. Kur PZAP konstaton shkelje dhe shqipton dënim apo kur lëshon një urdhëresë që detyron subjektin i cili duhet të veproj sipas atij urdhri, PZAP në vendimin për dënim apo në urdhër përcakton kohen brenda së cilës duhet të përmbushet pagesa e dënimit apo zbatimi i urdhëresës siç përcaktohet në nenin 120 paragrafi 2. të LZP-së. Nëse Subjekti që i është shqiptuar dënimi apo ndaj të cilit është lëshuar urdhri për veprim të caktuar, nuk zbaton detyrimet e caktuara sipas vendimit apo urdhëresë brenda Afatit të përcaktuar, atëherë PZAP mund të shqiptoj dënime shtesë për shkak të mos veprimit sipas vendimit që përbën shkelje të re, e për të cilën mund të shqiptoj gjobe deri në maksimumin e paraparë me LZP, por me këtë rast merr për baze shkaqet si:

15.1. Cila është natyra e shkeljes që është konstatuar,

15.2. Cila është lartësia e gjobës së shqiptuar,

15.3. Cili është detyrimi i urdhëruar ndaj përgjegjësit për ta ndërmarr,

15.4. A kanë cenuar veprimet e tilla rend shkeljet e rregullave për zgjedhje,



15.5. A përbën mos zbatim i vendimit mosrespektim të hapur të vendimeve të PZAP dhe rregullave për zgjedhjet,

15.6. A ka rrethana që qojnë në një përfundim se përmes mos pagesës apo mos zbatimit të urdhëresës, minohet procesi zgjedhor.

15.7. Duke i vlerësuar këto rrethana PZAP, përcakton edhe lartësinë e Gjobës që duhet shqiptuar subjektit përgjegjës për shkak të mos zbatimit të vendimit qoftë për pagesën e gjobës së shqiptuar apo për ndërmarrjen e veprimit sipas urdhëresës së PZAP.

16. Vendimet e PZAP-it, për shqiptimin e gjobave ndaj subjekteve politike janë përfundimtare dhe të ekzekutueshme ashti siç parashihet me nenin 14 paragrafi 3 të kësaj rregullore.

17. Subjekti politik i sanksionuar është i obliguar që ta paguaj shumën e gjobës sipas afatit të përcaktuar në vendimin e PZAP-it. Fletëpagesa merret në zyrën e PZAP-it, dhe pas pagesës është e obliguar të dorëzoj kopje si dëshmi për pagesën e kryer.

18. Subjekti politik i sanksionuar nëse nuk e paguan shumën e gjobës sipas afatit të përcaktuar në vendimin e PZAP-it, sekretariati i PZAP-it, brenda 15 ditëve i dërgon një shkresë paralajmëruese subjektit se do të inicion procedurë ligjore për ekzekutimin e vendimit.

19. Shuma e gjobave të paguara për zbatimin e vendimeve të PZAP-it, depozitohen në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## **Neni 25**

### **Rastet me Elemente të Veprës Penale**

Kur në ankesë të paraqitur në PZAP, vlerësohet se ka dyshime të bazuara për përgjegjësi individuale, respektivisht ka elemente të veprës penale dhe të ndëshkueshme me Kodin Penal të Republikës së Kosovës, Paneli këto raste i dorëzon në Prokurorinë e Shtetit në kompetencë të mëtejme, sipas nenit 39 paragrafi 2 dhe nenit 46 i LZP-së.

## **Neni 26**

### **Rastet me elemente të përgjegjësisë së mediave**

Kur në ankesë të paraqitur në PZAP, vlerësohet se janë shkelur dispozitat e kapitullit VIII të LZP-ës, që kanë të bëjnë me mediat gjatë fushatës së zgjedhjeve, Paneli ankesat i përcjell për shqyrtim dhe vendosje në Komisionin e Pavarur për Media, KPM.

## **Neni 27**

### **Dërgimi dhe publikimi i vendimeve**

1. PZAP-i, u dorëzon kopjet e vendimeve të tij me shkrim në forme fizike dhe elektronike palëve të përfshira në procedurë brenda afatit të paraparë ligjor:

1.1. vendimi që ka të bëjë me përfshirjen apo përjashtimin e emrit nga lista e votueseve/LV-ja, i, dorëzohet palës brenda shtatëdhjetë e dy (72) orëve, nga momenti i pranimit të ankesës;

1.2. vendimi që ndikon në certifikimin e rezultateve të zgjedhjeve, i dorëzohet palës brenda shtatëdhjetëdy (72) orëve, nga momenti i pranimit të ankesës;

1.3. rastet e vendimeve tjera PZAP-i, i dorëzon palës brenda pesë (5) ditëve kalendarike.

2. Vendimi i PZAP-it, palës brenda Kosovës i dërgohet në mënyrën fizike ose elektronike, ndërsa ankueseve jashtë Kosove u dërgohet vetëm në mënyrën elektronike në email-adresën personale nga e cila është pranuar ankesa e ankuesit.

3. Vendimi që dorëzohet në kopjen fizike i bashkëngjitet shkresa përcjellëse të cilën pala pranuese është e obliguar të nënshkruaj në prani të zyrtarit kompetent të PZAP-it, e cila përmban numrin e vendimit, datën, orën dhe minutat e pranimit si dhe nënshkrimin e pranuesit.

4. Nëse marrësi - pranuesi nuk gjendet në vendin e përcaktuar të tij, nëpunësi i PZAP-it, bën një përpjekje të dytë për dorëzimin e vendimit. Në rast se pranuesi nuk gjendet as në përpjekjen e dytë apo refuzon marrjen e vendimit, nëpunësi i PZAP-it, bën shënim përkatës në fletë dorëzim dhe kur është e mundur e vërteton situatën me nënshkrimin e dy dëshmitarëve të pranishëm.

5. Në pamundësi të kontaktit me palët, dorëzimi i vendimit mund të bëhet duke u afishuar në derën e banimit, në arkën postare të banimit nëse ka, ose në selinë e subjektit politik.

6. Vendimi apo shkresat tjera të PZAP-it, palës mund ti dërgohen edhe nëpërmjet shërbimeve postare, për të cilën merr konfirmim për dorëzimin e tij nga posta.

## **Neni 28**

### **Përshtatshmëria dhe dykuptimësia**

Në rast të mos përfshirjes së ndonjë dispozite ligjore me këtë rregullore që i referohet procedurës së ankesës dhe vendimmarrjes ose ka kuptim ndryshe nga ligji, atëherë zbatohet drejtpërsëdrejti Ligji Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

**KAPITULLI VII**  
**DISPOZITAT KALIMTARE DHE PERFUNDIMTARE**

**Neni 29**  
**Shfuqizimi**

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore shfuqizohet:

1.1. Rregullorja Nr. 01/2022 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave dhe Apeleve të datës 04.11.2022.

**Neni 30**  
**Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas nënshkrimit nga Kryesuesi i PZAP-it.



Zenel LEKU

Kryesues i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Datë: 05/07/ 2024





REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS-SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTESA-IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE-  
ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

**Formular për parashtrimin e ankesës**

Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës  Zgjedhjet Komunale  Numri i regjistrimit /PZAP \_\_\_\_\_

**A. IDENTIFIKIMI I PARASHTRUESIT TË ANKESËS**

Nëse parashtruesi i ankesës është individ, subjekt politik apo organizatë

1. Emri i subjektit politik /organizatës që parashtron ankesën \_\_\_\_\_
2. Emri dhe Mbiemri i parashtruesit të ankesës \_\_\_\_\_
3. Adresa \_\_\_\_\_
4. Komuna \_\_\_\_\_
5. Numri personal 

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--
6. Nr. i telefonit \_\_\_\_\_
7. E-mali \_\_\_\_\_

**B. KRYESI I SUPOZUAR I SHKELJËS**

Nëse kryesi i supozuar është individ/organizatë apo subjekt politik:

1. Emri i individit/organizatës apo subjektit politik \_\_\_\_\_
2. Vendi/Komuna \_\_\_\_\_
3. Nr. i telefonit, e-mali (nëse dihen) \_\_\_\_\_

**C. LLOJI I ANKESË**

Ankesa parashtrohet lidhur me:

- |                          |   |
|--------------------------|---|
| <input type="checkbox"/> | Nominimin dhe emërimin e anëtarëve të Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve                              |
| <input type="checkbox"/> | Nominimin dhe emërimin e anëtarëve të Këshillave të Vendvotimeve                                      |
| <input type="checkbox"/> | Aplikimin e subjektit politik dhe kandidateve për pjesëmarrje në zgjedhje                             |
| <input type="checkbox"/> | Mos certifikimin e subjektit politik për pjesëmarrje në zgjedhje                                      |
| <input type="checkbox"/> | Refuzimin për mos certifikim të listës së kandidatëve për pjesëmarrje në zgjedhje                     |
| <input type="checkbox"/> | Refuzimin për mos përfshirje në listën e votuesve brenda dhe jashtë Kosovës                           |
| <input type="checkbox"/> | Mos certifikimin e Listës së Votuesve   |
| <input type="checkbox"/> | Aplikimin për regjistrim si votues me nevoja të veçanta   |
| <input type="checkbox"/> | Aplikimin për akreditim të vëzhgueseve  |
| <input type="checkbox"/> | Periudhën e votimit jashtë Kosovës  |
| <input type="checkbox"/> | Shkeljen e dispozitave të Kodi të Sjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët |
| <input type="checkbox"/> | Periudhën e fushatës së zgjedhjeve për subjektet politike   |
| <input type="checkbox"/> | Parregullsitë/shkeljet për ditën e zgjedhjeve   |
| <input type="checkbox"/> | Administrimin dhe numërimin në QKN dhe QNR  |
| <input type="checkbox"/> | Rinumërimin e votave ose përsëritja e votimit   |
| <input type="checkbox"/> | Shpalljen e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve nga KQZ-ja.                                       |
| <input type="checkbox"/> | Tjetër...   |

## Ç. ARSYEJA PËR ANKESË

Përshkruani ankesën tuaj në hollësi, duke përfshirë vendin, datën dhe kohën e shkeljes së pohuar. Luteni të përshkruani arsyet që ju besoni se shkelja e pretenduar ka ndodhur, dhe nëse është e mundur ta specifikoni dispozitën ligjore që mendoni se është shkelur. Bashkëngjitni kopjet e çfarëdo dëshmie që mbështet ankesën tuaj, dhe *MOS* bashkëngjitni dokumente origjinale. Nëse është e nevojshme, mund të bashkëngjitni fletë shtesë.

## D. DËSHMITARI /ËT E MUNDSHËM (BASHKANGJITUR EDHE DEKLARATAT)

Lutni të shënoni emrin dhe mbiemrin, organizatën ose subjektin politik nëse i përket dëshmitari(ët) i/e mundshëm. Nëse është e mundur, duhet të shënohen të dhënat për kontaktim (adresa, numri i telefonit, si dhe e-malin). Nëse është e nevojshme, mund të bashkëngjitni fletë shtesë.

Sipas njohurive që unë posedoj, informacioni i mësipërm është i saktë<sup>1</sup>. (Nëse parashtruesi i ankesës është organizatë ose subjekt politik, atëherë atë duhet ta nënshkruaj përfaqësuesi i autorizuar).

\_\_\_\_\_

**Emri dhe Mbiemri**

\_\_\_\_\_

**Nënshkrimi**

\_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_

**Data**

1. Personi ankesën në PZAP duhet ta parashtror brenda afateve të përcaktuara në Ligjin Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

2. Formulari i ankesës mund të merret në Sekretariatën e PZAP-së, në ueb-faqen [www.pzap-ks.org](http://www.pzap-ks.org), dhe në të gjitha qendrat e votimit në ditën e zgjedhjeve. Ankesa për votuesit brenda Kosovës dorëzohet me shkrim në PZAP, rruga "Migjeni" Ndërtesa e ish Bankës së Lubjanës - Kati -I- Prishtinë 10.000, Republika e Kosovës.

3. Votuesi jashtë Kosovës ankesën në PZAP mund ta dërgojë përmes postës në adresën e PZAP-it, e cila duhet të ketë vulën dhe pullën postare të postës së origjinës prej cilit vend është dërguar ankesa ose në mënyrë elektronike në adresën elektronike të PZAP-it, [Info@pzap-ks.org](mailto:Info@pzap-ks.org), e cila duhet të dërgohet nga email-i personal i ankuesit dhe duhet të jetë e nënshkruar e skanuar dhe t'i bashkëngjiten dokumentet të cilat identifikojnë ankuesin.